



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:Dhjetor 2020

Nr:

PROJEKTVENDIM

**PËR CAKTIMIN E NJËSIVE ADMINISTRATIVE KU DO TË KRIJOHEN SELITË E
KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR
KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronjat “b” dhe “n”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N

Referuar nenit 19, paragrafi 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese, nuk përcaktohet kompetenca për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e KZAZ.

Referuar detyrave të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 15 të Vendimit nr.5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, krijimi i Selisë së KZAZ-së në njësinë administrative që ofron barazlargësi nga qendrat e votimit në juridiksion e ZAZ-së përkatëse, dhe lehtësi logjistike të transportit rrugor, i shërben mirë organizimit të punës dhe veprimtarive të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në zonën e administrimit zgjedhor përkatës.



Data: ...Dhjetor 2020

Nr.

Caktimi i njësive administrative ku do të krijohen Selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 6, datë 30.11.2020 “Për miratimin e ngritjes së Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021”, miratoi ngritjen e 92 (nëntëdhjetë e dy) Zonave të Administrimit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

Referuar juridiksionit territorial të Zonave të Administrimit Zgjedhor që do të funksionojnë për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, duke analizuar dhe vlerësuar:

- shtrirjen dhe relievin gjeografik të Zonave të Administrimit Zgjedhor;
- numrin dhe pozicionin gjeografik të njësive administrative të përfshira në territorin e Zonave të Administrimit Zgjedhor;
- lehtësitë logjistike të transportit rrugor;
- praktikat e zgjedhjeve të mëparshme;

janë caktuar njësitë administrative ku do të krijohen Selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor që do të ngrihen për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “b” dhe “n”, dhe paragrafin 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, Selitë e KZAZ-ve do të krijohen në njësitë administrative, sipas përcaktimeve në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kryetarët e Bashkive, do të sigurojnë infrastrukturën logjistike për krijimin e Selive të KZAZ-ve, ambientin dhe mjetet e punës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

